

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 13523/16

LULJETA CITOZI KUNDËR SHQIPËRISË

dhe 4 kërkesa të tjera

(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 14 Shtator 2023 si një Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e Përkohshme e Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë kërkesën e mësipërme të depozituar në data të ndryshme paraqitur në tabelën bashkëlidhur,

Duke mbajtur në konsideratë deklaratat e paraqitura nga Qeveria e paditur sipas së cilave Gjykatës i kërkohej të përjashtonte kërkesën nga lista e çështjeve,

Pasi diskutoi, vendosi si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Lista e kërkesve është paraqitur në tabelën bashkëlidhur.

Ankesat e kërkesve bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 dhe nenit 13 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procesit gjyqësor dhe mungesën e mjeteve efektive, iu komunikuan Qeverisë Shqiptare (“Qeveria”).

LIGJI

Duke pasur në konsideratë lëndën e ngjashme të kërkesave, Gjykata e gjykon me vend t’i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

Pas negociatave të pasuksesshme për një zgjidhje miqësore, më 2 mars 2023, Qeveria informoi Gjykatën se propozonte të bëheshin deklaratat të njëanshme, me qëllim zgjidhjen e problematikave të ngritura nga këto ankesa.

Në vijim, Qeveria i kërkoj Gjykatës t’i përjashtonte kërkesat në përputhje me nenin 37 të Konventës.

Qeveria njohu shkeljen e të drejtave të kërkesve, në lidhje me parashikimin për “afat të arsyeshëm” të garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës dhe mungesën e një mjeti vendas efektiv, në kohën përkatëse, për sa i përket këtij aspekti. Qeveria ofronte t’iu paguante kërkesve shumat e detajuara në tabelën bashkëlidhur dhe fton Gjykatën t’i përjashtonte kërkesat nga lista e çështjeve në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës. Shumat do të konvertoheshin në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes së pagesës dhe do të paguheshin brenda tre muajve nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës. Në rast se këto shuma nuk do të shlyheshin brenda periudhës tremujore të përmendur më sipër, Qeveria merrte përsipër të paguante interes të thjeshtë për to, që nga përfundimi i asaj periudhe deri në shlyerje, në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagesës plus tre pikë përqindje.

Pagesa do të përbënte zgjidhjen përfundimtare të çështjeve.

Kërkesve iu dërguan kushtet e deklarimeve të njëanshme të Qeverisë disa javë përpara datës së këtij vendimi. Gjykata nuk ka marrë një përgjigje nga kërkesit ku të pranoheshin kushtet e deklarimeve.

Gjykata konstaton se neni 37 § 1 (c) i krijon mundësinë të përjashtojë çështjen nga lista e saj nëse:

“... për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës.”.

Në këtë mënyrë, ajo mund t'i përjashtojë kërkesat nga lista e saj e çështjeve në mbështetje të nenit 37 § 1 (c) sipas një deklarate të njëanshme bërë nga Qeveria përgjegjëse, edhe nëse kërkesit dëshirojnë që të vazhdojë shqyrtimi i çështjeve (shih, veçanërisht, vendimin *Tahsin Acar kundër Turqisë* (kundërshtimet paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§ 75–77, GJEDNJ 2003-VI).

Gjykata ka ndërtuar një praktikë gjyqësore të qartë dhe të gjerë në lidhje me ankesat që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e tepërt të procesit gjyqësor civil (shih, për shembull, *Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, 1 prill 2014, dhe *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010).

Duke theksuar parashtrimet në deklaratat e Qeverisë, si edhe shumën e kompensimit të propozuar – e cila përkon me shumat e akorduara në çështje të ngjashme – Gjykata gjykon se nuk justifikohet që ajo të vijojë me shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesave (neni 37 § 1 (c)).

Mbështetur në sa më sipër, Gjykata gjykon se për sa i përket të drejtave të njeriut sipas parashikimit të Konventës dhe Protokolleve të saj, Gjykatës nuk i kërkohet që të vijojë shqyrtimin e kërkesës (neni 37 § 1 *in fine*).

Së fundmi, Gjykata thekson se nëse Qeveria nuk respekton kushtet në deklaratat e saj të njëanshme, kërkesat mund të rikthehen në listën e çështjeve në mbështetje të nenit 37 § 2 të Konventës (shih *Josipović kundër Serbisë* (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Sipas sa më sipër, është me vend që çështjet të përjashtohen nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos t'i bashkojë kërkesat;

Mban në konsideratë kushtet në deklaratat e Qeverisë së paditur dhe angazhimet për të garantuar respektimin e premtimeve të bëra në të;

Vendos të përjashtojë kërkesat nga lista e saj e çështjeve, në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 5 tetor 2023.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSSEKRETARE E PËRKOHSHME

Ioannis Ktistakis
KRYETAR

SHTOJCË

Lista e kërkesave sipas së cilave paraqiten ankesa, në mbështetje me nenin 6 § 1 të Konventës (kohëzgjatje e tepërt e procesit gjyqësor civil)

Nr.	Ankesa nr. Data e paraqitjes	Emri i ankuesit Viti i lindjes	Data e marrjes së deklarimit të Qeverisë	Shuma e akorduar për dëmin pasuror dhe jopasuror për kërkues (në euro) ¹	Shuma akorduar për kostot dhe shpenzimet për kërkesë (në euro) ²
1	13523/16 29.2.2016	Luljeta CITOZI 1954	2.3.2023	1,200	250
2	21532/16 13.4.2016	Elmaz LUZI 1956		1,200	250
3	29335/16 16.5.2016	Mirbana BILALI 1974		1,200	250
4	29342/16 16.5.2016	ALB SECURITY 1998		1,200	250
5	32838/16 3.6.2016	Xhevair BREGU 1960		1,500	250

¹ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesve.

² Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesve.